

# POPULLI IM MË KA ZGJEDHUR

Përmes  
ligjeve që ne si  
deputetë i miratojmë,  
jeta juaj do të jetë më  
e lehtë, qytetarë të  
dashur

Andaj,  
me shumë  
vullnet dhe përkushtim  
do t'i përfaqësojë  
kërkesat e të gjithëve  
në Kuvend



# QË TË JEM PËRFAQËSUES

## DEMOKRACIA, LIRIA JONË

LORETA (15), ERONA (14), ERMIRA (14), EDMOND (14)




**Kur kemi ardhur në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ nuk e kishim idenë se çka është demokracia dhe cilat janë vlerat përbërëse të saj. Por, me diskutim dhe shembuj të ndryshëm, arritëm ta kuptojmë vlerën e saj në jetën tonë. Ishim të befashuar nga të mirat që demokracia ofron për ne**

Demokracia që nga fillimet e para të saj, kishte një rëndësi të veçantë. Qytetarët e asaj kohe, e panë të nevojshme shpikjen e një sistemi të qeverisjes, ku vetë ata do të vendosnin për vendin e tyre. Pikërisht, ky sistem i

Edhe në shtetin tonë Kosovën, mbizotëron demokracia që nga viti 2008. Që nga ajo kohë, qytetarët kanë lirinë e plotë për ta qeverisur vendin. Me demokraci njerëzit e kuptojnë thelbin e fjalës liri. Ky sistem na mundëson të kuptojmë rëndësinë e të drejtave tona, mbi të gjitha, rëndësinë e vendosjes për veten pa u imponuar nga askush tjetër.

Ju ftojme që ta kuptoni se aq sa juve iu ndihmon demokracia dhe iu jep përkrahje për të qenë të lirë, aq edhe ne duhet ta ndihmojmë zhvillimin e saj. Përsërisim se nëse sot gëzojmë tërë këto të drejta dhe liri është falë demokracisë dhe kontributit të vazhduar që qytetarët e kanë dhënë për ta përmirësuar zhvillimin e saj.



**Barazia, shtylla e demokracisë. Prandaj, ta trajtojmë njëri-tjetrin të barabartë**

qeverisjes u shfaq në vitin 507 p.e.s. në Athinë, kryeqytetin e Greqisë. Nëse sot ndihemi të lirë, nëse kemi të drejtat e barabarta, nëse lëvizim dhe zgjedhim lirishtëm, atëherë krejt kjo është falë sistemit më të mirë të qeverisjes, demokracisë. Vlera e këtij sistemi është vërejtur më së shumti atëherë kur qytetarët kanë ngritur zërin për të drejtat e tyre dhe kanë kërkuar trajtim të barabartë në të gjitha sferat e jetës.



**Autorë me shumëtribute të mira**

# UNË DUA TË PËRFAQËSOHEM, ANDAJ PO VOTOJ

EROLINDA (15), ARDIT (14), ARMEND (15), DELVINA (16), BLERONA (16), AGNESA (15), ALBINA (14)



**Ne, nxënësit e shkollës „Pavarësia“ do të informohemi më shumë për rëndësinë e votës. E dijmë që ju mund të keni mjaftueshëm informata për këtë çështje, mirëpo, mendojmë që kurrë nuk është e tepërt të mësojmë gjëra të reja për një temë të caktuar. Sidomos kur këto informata vijnë nga nxënësit e shkollës fillore për një temë aq të rëndësishme**

Kur ne zgjedhim duhet të kemi në dispozicion dy ose më shumë mundësi, dhe ndër to ne përzgjedhim njëjërën. Po të kishim më pak se dy mundësi, atëherë, nuk mund të themi se kemi bërë ndonjë zgjedhje. Në këto rrethana, mund të themi që përkundër mundësive të pakta që kishim, ne e morëm të vetmen mundësi që kishim në dispozicion. E kjo për ne nuk është zgjedhje e lirë.



Në Kosovë qytetarët marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe ato lokale. Në zgjedhjet qendrore qytetarët votojnë për kandidatët për deputetë, të cilët punojnë në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa, në zgjedhjet lokale qytetarët votojnë për kandidatët për assemble komunale, si dhe për kryetarin e komunës. Që të marrin pjesë në këto zgjedhje, qytetarët duhet të jenë mbi moshën 18 vjeçare. Rëndësia e votës është shumë

e madhe, sepse çdo votë e qytetarit bën ndryshim. Edhe pse neve nuk na takon ende me ligj të marrim pjesë në këto zgjedhje, ne dëshirojmë të paraqesim një shembull që ne në klasë e kemi bërë. Zgjedhjet ishin për të votuar një nga tre kandidatët të cilët i kemi propozuar ne, si kryetar/e të Skënderajt. Kandidatja që mori më së shumti vota ishte shoqja jonë. Mirëpo, për t'i vënë në praktikë të gjitha premtimet, ajo tha që kam nevojë për ndihmën tuaj.

„Unë nuk mund t'ia dal pa ju, ashtu siç nuk mundën përfaqësuesit pa popullin. Votat tuaja më japin fuqi dhe më kanë vënë në pushtet. Këtë pushtet do të vë në shërbim dhe në favor të të gjithë juve,“ tha shoqja jonë e cila e mori me përgjegjësi detyrën e saj, ndonëse ishim duke luajtur. Faleminderit të dashur për vëmendjen e dhënë ndaj këtij artikulli.



Përfaqësuesit e shkollës „Pavarësia“



# QYTETARË TË PËRGJEGJSHËM DHE KREATIV

GRESA (14), MAJLINDA (14), ARJANIT (15)

**Qytetaria aktive mund të themi lirshëm se është baza e një demokracie të mirëfilltë. Pa qytetarët aktiv, asnjëherë nuk do ta kishim demokracinë në nivelin që është sot. Prandaj, edhe ne kemi zgjedhur të jemi të tillë. Se çka bëjnë zakonisht qytetarët aktiv, shikoni vizatimet e bashkangjitura në artikull**


Ne zbatojmë ligjet dhe respektojmë të drejtat e të tjerëve. Po ashtu, mbajmë përgjegjësi për veprimet që bëjmë. Familjarët tanë paguajnë rregullisht taksat dhe detyrimet që i kanë ndaj shtetit, dalin dhe votojnë, si dhe bashkërisht i zbatojmë vlerat e demokracisë. Tërë këto veprime apo sjellje i bëjmë në mënyrë që të tregohemi sa më shumë qytetarë aktiv. Ne e dijmë se ajo çka i dallon qytetarët mes vete është pikërisht angazhimi i tyre. Këtë e themi duke u bazuar në atë se a tregohen qytetarët aktiv apo pasiv. Edhe për vendimet që shteti ynë merr për ne, nëse ato nuk na pëlqejnë, ne si qytetarë aktiv mund të protestojmë dhe ta ngrisim zërin tonë. Nëse ne nuk aktivizohemi, kush presim që ta bëjë këtë për ne?




Marrim pjesë edhe në OJQ të ndryshme, duke e ditur se edhe ky veprim është pjesë e qytetarisë aktive



Qytetarët aktiv respektojnë ligjet me përpikmëri



Qytetarët aktiv nënshkruajnë peticione





Qytetarët aktiv ia dijnë vlerën votës



Qytetarët aktiv luajnë dhe bashkëpunojnë me të tjerët

# KUVENDI, ZËRI I POPULLIT

FLORENT (14), FLORENTINA (15), DITJON (14), ARMEND (14), ELMEDINA (15), ERONA (15), ARNISA (15)



**Lexues të dashur, ne jemi nxënësit e shkollës „Pavarësia“ nga fshati Krasaliq të komunës së Skënderajit. Ne kemi punuar një artikull me përplot informata për një temë shumë interesante. Cila është ajo? Çfarë rëndësie ka kjo temë në jetën tonë? A duhet edhe ne fëmijët të mësojmë për këtë temë? Për këtë dhe më shumë, lexoni në vazhdim**

Shumë gjëra për të cilat diskutuam sot ne nuk i kemi ditur. E gjeni dot se ku ishim kur diskutuam? Mmm..! Ne ishim në Organizatën Toka dhe në Punëtoritë për Demokraci „Demos-ti“, vendi ku ne e shtuam dyfishin e diturisë sonë. Ehh, kush nuk do të dëshironte të ishte në vendin tonë? Keni interesim të dini se çfarë mësuam ne? Pa dyshim, tani ne do t’iu tregojmë!

Ne mësuam për „Shtëpinë e Popullit“. Kjo Shtëpi është Kuvendi i Kosovës. Ne si qytetarë të Kosovës, të cilët ia dëshirojmë të gjitha të mirat vendit tonë, kemi të drejtë të zgjedhim udhëheqësinë tonë.

Ky proces zhvillohet në bazë të votave tona. Votat tona së pari shkojnë për zërin tonë, i cili përfaqësohet nga deputetët. Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë. Të gjithë janë përfaqësuesit tanë, pa marrë parasysh etninë e tyre, racën, fenë, besimet, qëndrimet politike, etj. Por, a e dini ju kush e fiton pushtetin nga votat e deputetëve? Në bazë të votave të deputetëve zgjedhet Kryeministri, i cili bashkë me ministrat punon në Qeveri, zgjedhet Kryetari i Kuvendit, Presidenti i vendit tonë, etj. Mirëpo, në qoftë se ata nuk iu përmbahen detyrave për të cilat edhe e kanë marrë postin e caktuar, deputetët kanë të drejtën t’i shkarkojnë ata nga ai post dhe postin t’ia caktojnë një personi



**Shkrimtarët dhe piktorët e këtij artikulli**

tjetër, i cili do të përmbush me privilegj dhe dashuri të gjitha detyrat që i posedon.

Ne gjithashtu diskutuam edhe për ligjet e ndryshme, të cilat votohen pikërisht nga deputetët dhe pas miratimit shkojnë në Qeveri për t’u ekzekutuar. Pas kësaj, ato duhet të respektohen nga i gjithë populli.

Një ndër ligjet që e dëgjojmë shpesh është edhe Ligji mbi të Drejtat e Fëmijëve. Në bazë të këtij ligji, mbrohen të drejtat e çdo fëmiju.

Këto janë disa nga të drejtat e tjera: e drejta e shkolimit, e drejta e shprehjes së lirë, etj. Ne si fëmijë kemi shumë dëshirë që nevojat tona të plotësohen nga përfaqësuesit tanë. Kurse, në të ardhmen do të përpiqemi që vetë të bëhemi përfaqësues.





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Krasaliq, Skënderaj